



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:277506
Datë: 29.04.2024
Numri i dokumentit: 05637073

KPPP.nr.2127/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përbarimore të kreditorit “DAKU PS” Sh.P.K., me seli në Gjilan, Rr. “Beqir Musliu II”, nr.8, me NUI: 810863060, kundër debitorit “AlbioniFix” Sh.P.K., me seli në Mitrovicë, Rr. “Sami Raqa” pn, me NUI: 812025551, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “Halimi Associates Law Firm” me seli të zyrës në Mitrovicë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.732/23 të datës 18.10.2023, të nxjerrë nga Përbaruesi Privat Kushtrim Musa me seli të zyrës në Gjilan, jashtë seancës me datë 24.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

1. REFUZOHET NË TËRËSI i pabazuar prapësimi i debitorit “AlbioniFix” Sh.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit P.nr.732/23 të datës 18.10.2023, të nxjerrë nga Përbaruesi Privat Kushtrim Musa, dhe i njehti Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, me Urdhrin Përbarimor P.nr.732/23 të datës 18.10.2023, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, e ka caktuar përbarimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm–faturës nr.Fat-10/2023 të datës 27.03.2022, me të cilin ka urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri t’i paguaj kreditorit në emër të borxhit, shumën

prej 6,000.00 Euro me kamatë prej 8 % nga data e lejimit deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

Kundër urdhrit të Përbaruesit Privat, debitori ka ushtruar prapësim për shkak se dokumenti në bazë të të cilit është marr urdhri përbarues nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përbarueshmërisë. Më tej ka theksuar se fatura nuk përmban titull ekzekutiv për faktin se e njejta nuk është e vulosur nga ana e debitorit, e që konsiderojmë se atëherë në tërësi do të ishte një faturë e cila i plotëson kriteret për dokument të besueshëm. Ka shtuar se debitori vazhdimisht ka qenë në gjendje gatishmërie gjatë gjithë periudhës së bashkëpunimit të jetë i rregullt me pagesa, dhe ka qenë i gatshëm që obligimin ta paguaj me rata por kreditori ka refuzuar. I ka propozuar gjykatës që debitorit t'i mundësohet që ta paguaj obligimin ndaj kreditorit nga 1000 Euro në muaj nga data 01-07. Po ashtu gjykatës i ka propozuar që të aprovohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit ndërsa të shfuqizohet urdhri për përbarim i nxjerrë nga Përbaruesi Privat, si dhe të obligohet kreditori që t'i paguaj shpenzimet përbarimore sipas tarifës.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka theksuar se ka kërkuar drejtëpërdrejtë nga debitori që ta paguaj obligimin që ka ndaj kompanisë, mirëpo asnjëherë nuk e ka paguar. Më tej ka theksuar se procedura përbarimore është iniciuar në bazë të faturës e cila i plotëson kushtet ligjore sipas ligjit të procedurës përbarimore, ku faturat janë origjinale, me të gjitha elementet që duhet t'i ketë një faturë sipas ligjit, dhe nuk ka pasur asnjë vërejtje nga ana e debitorit. Ka shtuar se pretendimet e debitorit në prapësim janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj, për arsye se nuk ka ofruar prova të mjaftueshme në mbështetje të pretendimeve të tij, siç është paraparë me nenin 69 par.4 të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit dhe të vërtetohet si i bazuar urdhri për lejimin e përbarimit.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, deklarimeve në përgjigje në prapësim të kreditorit, dhe pas analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe*

se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar". Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *"Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit."*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata, nga shkresat e lëndës, ka evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbarim dokumentin e besueshëm/faturën nr.Fat-10/2023 të datës 27.03.2022, me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura e lartcekur i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, është përcaktuar koha e përmbushjes së detyrimit monetar, e njejta është dorëzuar në origjinal dhe është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt ky i cili vërtetohet me nënshkrimin e debitorit.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Në kuptim të nenit 73 të LPP-së, gjykata lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2127/23, me datë 24.04.2024

Gj y q t a r i
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.